



**BASHKIA
TIRANË**
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.138, datë 05.10.2020

**“PËR
DHURIMIN E PASURISË NR. 2/29, ZONA KADASTRALE 8280 NGA BASHKIA
TIRANË NË FAVOR TË KISHËS ORTHODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË
PËR NDËRTIMIN E KISHËS SË SHËN PROKOPIT”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, pika 1.6, shkronja “a”, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 712, datë 09.09.2020, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të pasurisë 2/29, me vendndodhje në zonën kadastrale 8280”, si dhe në vijim të shkresës me nr. 31966 prot, datë 22.9.2020, të Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë drejtuar Bashkisë Tiranë, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Dhurimin e pasurisë nr. 2/29, me vendndodhje në zonën kadastrale 8280, nga Bashkia Tiranë në favor të Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, dhurohet për ndërtimin e Kishës së “Shën Prokopit”.
3. Në zbatim të parashikimeve të këtij vendimi, ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së dhurimit me Kishën Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë.
4. Çdo parashikim tjetër në vendimet e këshillit bashkiak për sa i përket pasurisë nr. 2/29 dhe që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohet.
5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU